

Difteria:

Çka duhet të dini

Difteria është sëmundje bakteriale ngjitëse e shkaktuar nga shtamet toksinë prodhuese të specieve *Corynebacterium diphtheriae*.

Forma më e shpeshtë e difterisë është forma respiratore. Kjo karakterizohet me inflamacion të rëndë të traktit të sipërm respirator me formim të membranave dhe dëmtim të organeve tjera, veçanërisht në miokard (muskulin e zemrës) dhe fije nervore periferike.

Difteria gjithashtu mund të prekë lëkurën, e njohur si difteria e lëkurës, dhe rrallë mukozat e organeve gjenitale dhe të syve.

Difteria në formën e saj respiratore mund të komplikohet me formë të rëndë duke shkaktuar vdekjen.



Si përhapet difteria?

Difteria përhapet nga personi në person me kontakt fizik përmes sekrecioneve të frymëmarrjes nga pacienti ose nga mikrobartësi. Rrallëherë, personat mund të sëmuren nga prekja e plagëve të hapura ose rrobave të ndotura me sekrecione nga plagët e të sëmurit me difteri. Periudha e inkubacionit është zakonisht dy deri në pesë ditë, herë pas here edhe më e gjatë.

Simptomat e difterisë respiratore

Karakterizohet me formimin e pllakave membranore të bardha, të cilat formohen në pjesën e pasme të fytit dhe në rrugët e sipërme të frymëmarrjes. Kjo shoqërohet me ethe, dhimbje të fytit, ënjtje të nyjeve limfatike në qafë dhe në raste të rënda vështirësi në frymëmarrje. Difteria respiratore mund të ngjasoj me infeksionet e fytit të shkaktuara nga baktere të tjera si faringiti streptokoksik.

Simptomat e difterisë së lëkurës

Difteria e lëkurës mund të shfaqet si skuqje e shkallëzuar ose ulçera me skaje të kufizuara qartë dhe membrana.

Si mund të parandalohet difteria?

Vaksinimi është mënyra më e mirë për t'u mbrojtur nga difteria dhe për të parandaluar shpërthimet. Imunizimi kundër difterisë fillon që në foshnjërinë e hershme me një vaksinë që mbron kundër difterisë, tetanosit dhe kollës së mirë (pertusisit), e njohur si DTP, ose me një vaksinë që përfshin DTP-në si dhe një ose më shumë nga këto: *Haemophilus influenzae* tip B, poliomyelilit (polio) ose hepatit B.

Pas vaksinimit primar në vitin e parë të jetës është thelbësore të merren vaksina përforcuese të vaksinës së difterisë për të zgjatur imunitetin, pasi kjo zbehet me kalimin e kohës.

Vaksinimi është i sigurt dhe efektiv. Mund të ketë disa efekte anësore të lehta, duke përfshirë temperaturë të lehtë, përgjumje ose ndjeshmëri në vendin e injektimit.



Cili është trajtimi i difterisë?

Difteria respiratore trajtohet me antitoksinë të difterisë dhe antibiotikë. Mund të nevojitet frymëmarrje artificiale dhe mirëmbajtje e rrugëve të frymëmarrjes. Kjo formë e difterisë paraqitet me shkallë të vdekshmërisë 5-10% edhe me trajtim. Trajtimi i difterisë së lëkurës me antibiotikë zakonisht është i mjaftueshëm dhe nuk nevojitet trajtimi me antitoksinë.